

V E N D I M
Nr. 92, datë 13.5.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Tefta Zaka	Anëtare e “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 28.2.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.39 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: VASILIQI LEKA, përfaqësuar nga avokatët Dashamir Kore e Rahman Osmani, me prokurë.

SUBJEKTE Të INTERESUARA: PAVLLO, MARIA E LIRI KISI, etj., përfaqësuar nga avokat Arben Hakani, me prokurë.

O B J E K T I: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.70, datë 28.6.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE:Nenet 42 e 131/f të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Kolegjeve të Bashkuara, kërkuesi ka pretenduar se është shkelur e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar:

- Kolegjet e Bashkuara kanë zhvilluar seancat gjyqësore në mungesë të kërkuesit, pa i dorëzuar atij kopjen e rekursit dhe pa i njoftuar datën e gjyqit. Gjykata e Rrethit Tiranë, ka adresuar një lajmërim-marrje në adresën e mëparshme të kërkuesit dhe jo në adresën ku banon që prej tre vjetësh. Mosmarrja e rekursit rezulton edhe nga shënimi që është bërë në lajmërim-marrje: “kthehet, adresë e pasaktë”.

- Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke bërë vlerësim provash, kanë ushtruar funksione të juridiksionit fillestar. Ky është një veprim i kundërligjshëm dhe antikushtetues sepse kjo Gjykatë ka vetëm funksion rishikues të vendimeve të gjykatave më të ulëta, brenda kufijve të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile dhe jo të drejtën të shqyrtojë nga pikëpamja e vlerësimit të provave themelin e çështjes.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Petrit Plloçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.172, datë 22.1.1996, ka pranuar padinë, duke detyruar palën e paditur të njohë të drejtën trashëgimore të Petro Kisit mbi pasurinë e Marije Lekës dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të dëshmisë së trashëgimisë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.2767, datë 3.5.1996, ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe duke e gjykuar çështjen në fakt, rrëzimin e padisë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1550, datë 30.6.1996, në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.70, datë 28.6.2001, kanë vendosur: “a) Prishjen e vendimeve nr.1550, datë 30.10.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.2767, datë 3.5.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë; b) Lënien në fuqi të vendimit nr.172, datë 22.1.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë për pjesën që detyron të paditurit të njohin të drejtën trashëgimore të paditësve mbi pasurinë e Marije Lekës, si dhe rrëzimin e padisë e pushimin e gjykimit për pjesët e tjera”.

Me kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkuesja Vasiliqi Leka ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të mësipërm të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar se i është shkelur e drejta për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës. Si element të një procesi jo të rregullt ligjor kërkuesja ka parashtruar zhvillimin e gjykimit në mungesë të saj, pa iu dorëzuar një kopje e rekursit dhe pa pasur dijeni për ditën e gjyqit.

Nga shqyrtimi i çështjes, Gjykata Kushtetuese, arrin në konkluzionin se pretendimi i kërkueses është i bazuar.

Kështu, ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Tiranë, me anë të një lajmërim-marrje, një kopje të rekursit të paraqitur nga pala tjetër, ia ka adresuar kërkueses Vasiliqi Leka, por ky lajmërim-marrje është kthyer sepse adresa ka qenë e pasaktë. Në këto rrethana, kërkuesja duke mos marrë rekursin nuk ka ndjekur as shpalljet që afishon Gjykata e Lartë për të marrë njoftim për ditën e gjykimit dhe siç rezulton edhe nga dosja, gjykimi në Kolegjet e Bashkuara, është bërë në mungesë të saj. Është e vërtetë se në dosje ndodhet edhe një shpallje njëmuajore, por gjykata nuk duhet të procedonte me këtë mënyrë njoftimi, pa bërë ndonjë verifikim nëse ishte i mundur njoftimi sipas neneve 130-132 të Kodit të Procedurës Civile. Vetëm në rast se konkludohej se kjo gjë nuk mund të bëhej, atëherë mund të procedohej me njoftimin me shpallje, siç parashikohet në nenin 133 të këtij Kodi. Përveç kësaj, megjithëse shpallja mban datën 15.4.2001, nga përmbajtja e saj del sikur kjo shpallje të jetë nxjerrë për të njoftuar një ankim kundër një vendimi të gjykatës së apelit. Në këto kushte, përderisa në rastin në shqyrtim nuk janë respektuar rregullat procedurale për njoftimin e akteve, Gjykata konkludon se gjykimi në Kolegjet e Bashkuara në mungesë të kërkueses, përbën shkelje të të drejtës së saj të mbrojtjes, e cila është një e drejtë themelore. Pikërisht kjo shkelje, e cila cenon një nga parimet bazë për një proces të rregullt ligjor, e bën antikushtetues vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Për sa mësipër, kërkesa e paraqitur nga kërkuesja Vasiliqi Leka duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.70, datë 28.6.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.